



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr.70, datë 18.04.2025

PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT
NR.11, DATË 29.05.2024 “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE
ADMINISTRATIVE TË SHFUQIZIMIT DHE REFUZIMIT TË LEJEVE TË
ZHVILLIMIT TË MIRATUARA NGA KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 27, 28, pika 1, dhe 39, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit pasi mori në shqyrtim propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 11, datë 29.05.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e procedurave administrative të shfuqizimit dhe refuzimit të lejeve të zhvillimit të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

- Pika 2 ndryshohet sipas përmbajtjes më poshtë:

2. *Refuzimin e aplikimeve për leje zhvillimi, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, për të gjitha rastet e refuzimit automatik nga sistemi elektronik i lejeve të ndërtimit, pasi aplikuesit nuk kanë ndjekur procedurat dhe afatet ligjore për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga Sekretariati teknik i KKTU-së.*

- Pika 3 ndryshohet sipas përmbajtjes më poshtë:

3. *Refuzimin e aplikimeve për leje zhvillimi, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, për të gjitha rastet kur subjektet zhvilluese nëpërmjet deklaratave noteriale kanë kërkuar tërheqjen e aplikimeve për leje zhvillimi.*

- Kudo në tekstin e Vendimit Nr. 11, datë 29.05.2024 togfjalëshi “Këshillit Kombëtar i Territorit” zëvendësohet me togfjalëshin “Këshillit Kombëtar i Territorit dhe Ujit”.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

ADELAJDA ROKA

